



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK NR.4

Nr. **63** prot

Tiranë më **22.01.2026**

Lënda: Njoftim për levizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Ne zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" : të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554, datë 31.07.2019, "Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të Vazhduar profesional të personelit",

QFPP Nr.4, ju njofton krijimin e lëvizjes paralele për pozicionin instruktor me kohë të pjesshme

Instruktor/e për kursin Udhërrëfim Turistik---1 Person

Instruktor/e për kursin Kujdestari Fëmijësh, Kujdestar për të moshuar-----1 Person

Instruktor/e për kursin Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike, Termohidraulike -2 Persona

Instruktor/e për kursin Berber----1 Person

Instruktor/e për kursin Kopshtari-----1 Person

Instruktor/e për kursin Shërbim shitje dhe Sipërmarrje dhe Memaxhim i Biznesit të Vogël---1 Person

Instruktor/e për kursin Asistent e kujdesit afatgjat, Kujdestar Social, PAK-----1 Person

Instruktor/e për kursin Aftësi për punësim---1 Person

Instruktor/e për kursin Automekanik, Servis elektroauto në automjete të lehta, Servis motorri në automjete të lehta, Servis xhenerik në automjete të lehta -----2 Persona

Instruktor/e për kursin Sekretari Arkivë-----1 Person

Instruktor/e për kursin Instalime dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrike--3 Persona

Instruktor/e për kursin Kuzhinë-----3 Persona

Instruktor/e për kursin Riparim i paisjeve Audio Televizive, Riparim kompjuteri, Riparime elektroshtëpiake-----1 Person

Instruktor/e për kursin Parukeri, Manikyr dhe Pedikyr-----3 Person

Instruktor/e për kursin Rrobaqepsi dhe Modelim Veshjesh për femra-----1 Person
Instruktor/e për kursin Web Design, Graphic Design, Aftësi Digjitale-----2 Persona
Instruktor/e për kursin Administrator ndërtesash.....1 Person
Instruktor/e për kursin Mobileri-----1 Person
Instruktor/e për kursin Anglisht-----1 Person
Instruktor/e për kursin Punime ndërtimi, Bojatisje, Hekurkthyes, Sisteme të thata në ndërtesa,
Punime Plakashtrimi, Punime muratimi dhe suvatimi, Karpentier----- 1 Person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- d) aftësi të tjera nëse kërkohen.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a. letërmotivimin për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV në);
- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën;
- e. librezën e punës;
- f. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g. certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i. vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j. vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- k. të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të AFP-së, brenda datës ... **30.01.2026**

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 27.5.2024,

"Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e

njesisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin

DREJTOR
Valbona Hoxha

